



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:065973

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05857180

KF.nr.419/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Artmotion” Sh.P.K., me NRF 601754650 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti kundërvajtje doganore, vlera e kontestit 750.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 14.06.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Gentiana Behluli dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Artmotion” ShPK me NRF 601754650 dhe seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 01.3.2.2/862/2017 i datës 01.03.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë më 08.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar anulimin e vendimit 01.3.2.2/862/2017 të datës 01.03.2021. Si në padi ashtu edhe në seancat gjyqësore, deklaroi se e paditura edhe pse ka qenë e obliguar që të vendos në bazë të rekomandimeve

të aktgjykimit A.nr.182/18 të datës 03.11.2020 nuk ka vepruar sipas këtij aktgjykimi dhe përsëri e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të vendimit të sektorit për kundërvajtje. Edhe pse paditësi ka bërë deklarin e mallit sipas dokumentacionit përcjellës të mallit e paditura ka konsideruar se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore pasi ka tentuar shmangien nga pagesa e detyrimeve doganore, fakt të cilën e paditura nuk ka mundur të vërtetojë duke marrë parasysh faktin se paditësi nuk ka bërë asnjë deklarin i cili nuk përkon me dokumentet të cilat gjenden në dokumentet e bashkangjitura DUD-it kontestues, fakt i cili tregon se paditësi nuk ka tentuar asnjë shmangie nga detyrimet doganore, por siç është theksuar edhe më lart deklarin është bërë në bazë të deklaratës eksportuese dhe të gjithë dokumenteve përcjellëse të mallit. Ka kundërshtuar konstatimin e të paditurës se paditësi ka bërë deklarin të rrejshëm dhe jo të saktë të numrit tarifor dhe për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet vendimi i kontestuar dhe paditësit ti kthehet shuma e paguar në emër të gjobës ose të lirohet nga gjoba.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 09.03.2022, e ka kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazuar. Ajo theksoi se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi, dhe pretendimet e palës paditëse nuk janë të vërtetuara me asnjë provë të vetme. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, e paditura kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, duke mbetur pranë përgjigjes në padi dhe aktvendimit të Doganës së Kosovës, i cili refuzoi ankesën e paditësit si të pabazuar. Ka shtuar se e paditura fillimisht konsideron se padia e paditësit është e pas afatshme duke konsideruar se data e pranimit të aktvendimit është 04.03.2021, ndërsa padia është paraqitur me datë 08.04.2021, andaj gjykatës i ka kërkuar që padinë ta hedhë poshtë si të pas afatshme. Më tej ka theksuar se pretendimet e paditësit se ky vendim është marrë në shkelje ligjore nuk mund të mbështet në asnjë provë të vetme. Dogana e Kosovës pasi ka pranuar aktgjykimin A.nr. 182/18 ka adresuar të gjitha vërejtjet e gjykatës dhe ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtimin e aktvendimit me pretendimet e paditësit është e pabazuar pasi që ekzistojnë të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse e cila parashihet në nenin 276 pika k) e KDAK-së dhe këtë e ka mbështetur edhe me mendimin tarifor dhe gjithashtu ka sqaruar se në bazë të KDAK-së dhe Udhëzimit Administrativ 11/2009 Dogana i ka sqaruar gjykatës dhe subjektit paditës se përgjegjësia për deklarin e mallit i bie përfaqësuesit të deklaruesit dhe vet deklaruesit të mallit, andaj i njëjti ka për obligim që të deklarojë informacione të sakta në lidhje me mallin. Më tej ka shtuar se gjithashtu vërtetësia e dokumenteve që i

bashkëngjitet Deklaratës doganore të jetë e saktë dhe të korrespondojë me gjendjen reale të mallit, pasi që i njëjti është njohës i specifikave të atij malli. Për saktësinë dhe vërtetësinë e numrit tarifor dogana ka dhënë një mendim i cili është sqaruar edhe një herë në arsyetimin e aktvendimit kontestues me pikë dhe me presje. Në fund ka theksuar se konsiderojnë se vendimi kontestues është tërësisht i bazuar në normativën ligjore të cilën dogana e aplikon për të gjitha palët.

Gjykata fillimisht trajtoj afatshmërinë e paraqitjes së padisë, dhe shkresat e lëndës ashtu që nga parashtrësja e dorëzuar nga paditësja me datë 12.06.2024, konfirmohet se paditësi ka pranuar vendimin kontestues me datë 04.03.2021, ndërsa e njëjta në gjykatë është dorëzuar me datë 06.04.2021. Afati i fundit për ushtrimin e padisë ka qenë data 03.04.2021 e cila ka qenë ditë e shtune. Me datë 04.04.2021 ka qenë festë zyrtare Pashkët Katolike, ndërsa dita e hënë datë 05.04.2021 ka qenë ditë pushimi. Rrjedhimisht, data e fundit për ushtrimin e padisë ka qenë data 06.04.2021, e që nga dëftesa për pranimin e dërgesave nga Posta e Kosovës e datës 06.04.2021 me numër serik 2064202161733 rezulton se paditësi ka ushtruar padinë brenda afatit ligjor.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 16.05.2024 ka administruar provat relevante si në vijim: Aktgjykimin nr.182/2018, Aktvendimi nr.01.3.2.2/862 /201701.03.2021, Aktvendimi 01.3.2.2/862 10.01.2018, Aktvendimi nr. 03.01.7-2017-1360 i datës 12.12.2017, Pagesa e datës 16.11.2017, Vërtetimi për periudhën 20.08.2016 deri 19.08.2019, Deklarata eksportuese pa numër, Faturat: nr.0000029249 e datës 28.11.2017, F2017/0083 18, nr.0000029248/28.1 1.2017, Dokumenti 16.05.2016, Mendimi për klasifikim tarifor 04.1.2 nr. 106/ 08.12.2017, DUD R-16860 i datës 07.12.2017, Ankesa e ushtruar në Doganë nr.862 e datës 20.12.2017, Deklarata e konformitetit, parashtrësja e datës 12.06.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigjen në padi, shkresat e lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, rezulton se e paditura Dogana e Kosovës – Zyra e Brendshme Doganore Aeroporti Terminal, duke u bazuar edhe në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr. 04.1.2 nr.106/08.12.2017, të dhënë nga Sektori i Tarifave i cili vepron në kuadër të të paditurës, ka ardhur në përfundim se paditësi me DUD-in kontestues R16860 të datës 07.12.2017, me rastin e zhdoganimit, nuk e ka deklaruar saktë kodin tariforë të mallit “ shasia të serverit me furnizues rryme dhe 6 x vende për Disk magnetik): PERSY STINGER = 1komplet me pjesë përcjellëse të ikuadruara në te: (shiqo infor faqe...)”, e që i njëjti mall është dashur të deklarohet në kodin 8471500090, ngase mallin i deklaruar në numrin –kodin tarifor 8471490090, lirohet nga taksa doganore, ndërsa është dashur të deklarohet me kodin 8471500090 në bazë të cilit kod malli duhet të paguaj taksat doganore 10 % dhe TVSH-së 8 % e cila reflekton edhe në ndryshimin e taksës së TVSH-së, ku me këtë veprim i është shmangur taksave në shumë prej 1,152.00 euro.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative, gjithmonë në rastet kur nuk kemi nga paditësi Informatë Tarifore Detyruese të shtetit eksportues apo i origjinës, për mallin kontestues.

Gjykata pretendimin e paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e konsideron të paqëndrueshëm, kjo për faktin se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë konflikt administrativ, Gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes DUD-ve kontestues, mbi bazën e të cilit deklarim paditësi është liruar nga pagesa e taksës doganore. Gjykata konstaton se në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të autoriteteve nga shteti eksportues apo i origjinës të deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit dhe/apo shqyrtimit gjyqësor, atëherë e paditura me të drejtë është bazuar në Mendimin për Klasifikim Tarifor 04.1.2 nr. 106/ 08.12.2017, të dhënë nga Sektori i Tarifave për mallra identike apo të ngjashme i cili vepron në kuadër të paditurës.

Gjykata duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, ku decidivisht përcaktohen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore, ashtu që në nenin 1, pika C përcaktohet se: *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar”*. konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura, por edhe Gjykatës ti ofrojë prova konkrete *”informatë tarifore detyruese”* për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut aplikohen lirime nga detyrimet doganore.

Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga vendi eksportues ose i origjinës së mallit, andaj Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestuese, për arsye se, e paditura Dogana e Kosovës referuar Mendimit për Klasifikim Tarifor nga Sektori i Tarifës 04.1.2 nr. 106/ 08.12.2017, me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret malli lëndor është dashur të tariforet sipas përshkrimit në numrin-kodin tarifor 8544499900, sipas të cilit kod tarifor për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% dhe TVSH-ja 8%.

Deri tek përfundim lidhur me klasifikimin e saktë tarifor e paditura ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK 2017, në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XVI, Kapitulli 84, dhe nënkrahëve 847149 dhe 847150, mostrave të dërguara, shpjegimeve plotësuese dhe informatave tjera.

Pretendimin e paditësit se me deklaratën eksportuese i njëjti mall është paraqitur me numër tarifor të deklaruar si në këtë deklaratë, Gjykata e ka gjetur si jo të bazuar, kjo për faktin se deklarata eksportuese përpilohet mbi bazën e faturës dhe të dokumenteve përcjellëse të mallit, dhe se e njëjta nuk është dokument për aplikim të preferencave tarifore në shtetin e destinimit.

Me nenin 24 par.1 të KDA-së është përcaktuar se: *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshëmrisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIKut, Tarifës*

Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor”, ndërsa në nenin 18, të këtij Kodi është përcaktuar se: “Dogana do të lëshojë informacion të detyrueshëm tarifor ose informacion të detyrueshëm të origjinës në bazë të kërkesës me shkrim, duke vepruar në përputhje me dispozitat për zbatimin e këtij Kodi andaj edhe nga kjo dispozitë del kompetenca e këtu të paditurës për të dhënë mendime tarifore për Doganën por edhe informata tarifore detyruese për palët. Tutje Kontrollimi i deklaratave pas zhdoganimit, mund të bëhet bazuar në nenin 82, par 1. të KDA-së, “Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave dhe më qëllim që të igurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”.

Rrjedhimisht, konform dispozitave ligjore të lartcekura, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklarimit të pa saktë të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues.

Si përfundim, Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr.01.3.2.2/862/2017 i datës 01.03.2021, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pikën III të këtij dispozitivi duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.419/22, datë 14.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.